

RRETHI KORÇË

"XH.F.KACOS" SH.P.K regjistruar me NIPT-in L54008001D

Adresa: Rr. "Rruga Korçë Bilisht", Kilometri i katërt, Belorta, Korce, Tel 0696867613.

PROJEKT MARREVESHJE BASHKIMI

Sot me date 14.11.2024 (Dymijeenezetekater), ne seline e shoqerise "Xh.F.Kacos"sh.p.k. u perpilua kjo Projekt Marreveshje Bashkimi me perthithje, ne referim te plote me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtare e Shoqerite Tregtare" Nenet 215-225, nga shoqerite si me poshte:

Shoqeria "Xh.F.Kacos" sh.p.k., person juridik i se drejtes shqiptare, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me seli ne Rruga Korce-Bilisht, km 4, Belorta, Korce, me numer NIPT-i L54008001D, qe perfaqesohet nga administratori I saj perfaqesuesi ligjor Z.Flavjo Kacos, shtetas shqiptar I biri I Arbenit, lindur ne Vreshtas, me date 18.07.2001, banues ne Vreshtas , mbajtes ID nr.034732738 madhor me aftesi te plote ligjore per te vepruar.

Me poshte e quajtur Shoqeria PERTHITHESE

Dhe

Shoqeria "Albapower"Sh.p.k., person juridik i se drejtes shqiptare, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me seli ne Luz i Vogel, Kavaje, numer NIPT-i L84726002K, qe perfaqesohet nga administratori i saj perfaqesuesja ligjore Zj.Esmeralda Lara, shtetase shqiptare E bija e Tekiut, lindur ne Podgorie, me date 15.07.1991, banuese ne Korçe, mbajtes ID nr. 038936849 madhore me aftesi te plote ligjore per te vepruar.

Me poshte e quajtur Shoqeria qe PERTHITHET

Duke patur parasysh dhe ne zbatim te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtare e Shoqerite Tregtare" Neni 216 pika 2 hartojme si me poshte:

PROJEKTIN E BASHKIMIT te shoqerive tregtare te permendura me siper. Palet bien dakort te lidhin kete marreveshje me kushtet e meposhtme:

1- DRJETIMI I BASHKIMIT

Ne kete projekt bashkimi te shoqerive tona tregtare nepermjet perthithjes, referuar neneve 215-225 Shoqeria "Xh.F.Kacos " Sh.p.k me NIPT: L54008001D, do te jete Shoqeria Perthithese e cituar ne vijim si Shoqeria Perfituese, kurse Shoqeria "Albapower" Sh.p.k me NIPT: L84726002K do te jete shoqeria e perthithur ne vijim si shoqeri Kontribuese.



2- MOTIVET DHE QELLIMET E BASHKIMIT

-Grupimi i Eksperiencave, Njohuri, Performances, Mjeteve, per rritjen e perfitimeve e rentabilitetit ne shoqerine Perthithese si dhe pasurimin e CV-se te saj ne fushen e tregtimit me shumice e pakice te materialeve te ndertimit, import eksportin e tyre, tregtim me shumice dhe me pakice te artikujve te tjere industriale. Transport kombetar dhe nderkombetar per mallra te ndryshem per te trete dhe me qira. Transport, grumbullim i mbetjeve te skrapit te hekurit dhe i metaleve te tjera me ngjyre.

- Motiv tjetër është se dy nga ortakët e shoqërisë Xh.F.Kacos Sh.p.k Flavjo Kacos dhe Marjeta Osmani janë ortakë edhe tek shoqëria Albapower Sh.p.k, prandaj për këtë arsye si edhe nisur nga fakti që të dyja shoqëritë kanë objekt të aktivitetit të njëjshëm dhe vlerësimin se mbajtja e të dy shoqërive si njësi të vecanta rrit kostot administrative si dhe ben me të vështirë administrimin e perditshëm të veprimtarive. Rrjedhimisht, është me e arsyeshme që këto shoqëri të riorganizohen dhe të bashkohen me qëllim që të ekzistojë vetëm një shoqëri. Meqenëse shoqëria Xh.F.Kacos Sh.p.k është njësi me e vjetër, me një historik tregtar me të gjatë, me volum me të madh të veprimtarive të kryera si dhe me vlerë me të lartë të bilanceve financiare, atëherë ka me shumë vlera të vijoje të ekzistojë shoqëria Xh.F.Kacos Sh.p.k dhe shoqëria Albapower Sh.p.k të perthithet prej saj.

3- AKTIVET dhe PASIVET(DETYRIMET) E PARASHIKUARA PËR TË TRANSFERUAR.

Ne zbatim të këtij operacioni Bashkimi nepermjet perthithjes parashikohet që shoqëria kontribuese "Albapower" Sh.p.k. të transferojë (kaloje) Shoqërisë "Xh.F.Kacos"Sh.p.k., teresisht elementet e Aktivit dhe Pasivit të saj, referuar në bilancin e saj në Pasqyrat Financiare të vitit 2023 duke përfshirë edhe ato të realizuara nga 1 Janari 2024 deri në Miratimin Perfundimtar të kësaj Marreveshje Bashkimi.

4- HUMBJE TE PRITSHME NUK KA.

Kapitali I Shoqërisë Kontribuese prej 13,000,000 leke, do të kalojë si kapital shtesë dhe do të bashkohet kapitalit të Shoqërisë perthithese apo perfituese "Xh.F.Kacos" Sh.p.k. Ndërsa fitime/humbjet do të jenë pjesë perberese e kapitaleve të veta të shoqërisë perthithese "Xh.F.Kacos "sh.p.k., pas perfundimit të operacionit të bashkimit.

5- MODALITETET:

- Shoqëria Perthithese "Xh.F.Kacos" Sh.p.k., do të jetë perfituese e kontributeve të shoqërisë "Albapower" Sh.p.k. në datën e realizimit perfundimtar të bashkimit.
 - Shoqëria Perthithese "Xh.F.Kacos"Sh.p.k. gezon frutet e bashkimit duke filluar nga data 14.11.2024 me kusht realizimin në fjalë.
- Perkundrajt kontributit të perfituar Shoqëria "Xh.F.Kacos" Sh.p.k., si shoqëri Perfituese nuk do të paguaje ndonjë cmim(detyrim) shoqërisë



kontribuese "Albapower" dhe do te marre nje pjese ne kapitalin e shoqerise Perfituese "Xh.F.Kacos" sh.p.k.

- Ne vazhdim shoqeria qe perthithet mbas transferimit te Aktivitetit te saj do te priset si shoqeri pa likujdim referuar Neni 220 germa c e Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtare e Shoqerite Tregtare".

- Te gjitha te drejtat e detyrimet do ti marre persiper shoqeria perfituese "Xh.F.Kacos" Sh.p.k. kundrejt te treteve dhe organeve shteterore.

- Raporti I kembimit eshte miratuar nga ortakët e dy shoqerive, te shoqerise perthithese e te perthithur, pra ne te dy shoqerite. Pra pas perfundimit te operacionit te perthithjes te shoqerise Albapower Shpk, struktura e ortakeve dhe niveli i pjesemarrjes ne shoqerine Xh.F.Kacos Sh.p.k do te rezultojne si vijon:

Ortaku	Përqindja e pjesëmarrjes
Flavjo Kacos	40%
Xhuliano Kacos	40%
Marjeta Osmani	20%
TOTAL	100%

Nga bashkimi me perthithje nuk rezulton ndryshim i ortakeve si dhe i kuotave qe zoterohen prej tyre, si dhe nuk do te rezultojne asnje shume e pagueshme ne para.

6- DATA KONTABEL

Ne aspektin e regjistrimeve kontabel te gjitha operacionet e veprimtarise te shoqerise Kontribuese "Albapower" Sh.p.k. nga data 01.01.2024 deri ne daten e miratimit dhe realizimit te bashkimit do te konsiderohen te kryera prej shoqerise perthithese "Xh.F.Kacos" sh.p.k.

7- RAPORTET E KEMBIMIT

- Bashkimi I te dy shoqerive nuk do te ndryshojë pjesët kontribuese ne perqindjet e zoteruesit te kapitalit te shoqerive.
- Raporti I kembimit te kuotave nuk do te kete ndryshim, dhe do te jete i njejte ashtu siç ishte para bashkimit.

8- KUSHTET E NDARJES SE KUOTAVE

Pas bashkimit me perthithje te shoqerise Albapower shpk struktura e ortakeve dhe niveli i pjesemarrjes ne shoqerine Xh.F.Kacos Sh.p.k do te rezultojne si vijon:

Ortaku	Përqindja e pjesëmarrjes
Flavjo Kacos	40%



Xhuliano Kacos	40%
Marjeta Osmani	20%
TOTAL	100%

Perqindja e ndarjes se dividendeve pas Bashkimit te shoqerive nuk do te kete ndryshime, pra ortakët e shoqerise perthithese "Xh.F.Kacos"Sh.p.k. do te perfitojne dividendet 100% te fitimeve te dy shoqerive pjesemarrrese ne operacionin e bashkimit(perthithjes).

9- SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TE BASHKIMIT

Kapitali prej 13,000,000 leke I Shoqerise Kontribuese "Albapower" Sh.p.k. mbas bashkimit zyrtar do te pasqyrohet ne Pasivin e Bilancit, si shtese Kapitali per Shoqerine Perthithese "Xh.F.Kacos"Sh.p.k., duke mos ndryshuar perqindjen te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise perthithese, dhe vlere e kapitalit qe bashkohet do te jete si prim I bashkimit ne shoqerine perthithese.

Kapitali I Shoqerise Perthithese "Xh.F.Kacos" Sh.p.k., prej 114,000,000 leke pas bashkimit me shoqerine Kontribuese "Albapower"Sh.p.k. do te ndryshoje, duke u bere ne vlere absolute prej 127,000,000 leke.


10- TE DREJTA DHE AVANTAZHE TE TJERA

Ky operacion bashkimi nepermjet perthithjes nuk do te permbaje, te drejta dhe avantazhe te vecanta pas perfundimit te operacionit te bashkimit. Me perjashtim te avantazhit qe shoqeria perthithese "Xh.F.Kacos" Sh.p.k. do te marre aktivet, me kushtin qe te marre persiper te gjitha te drejtat e detyrimet e shoqerise te perthithur "Albapower" sh.p.k., do ti kalojne shoqerise perthithese "Xh.F.Kacos"sh.p.k.

11- PASOJAT E BASHKIMIT

Bashkimi nuk do te kete asnje pasoje ndaj paleve te treta siç jane:

- Klientet, Debitoret, Kontratat, do te respektohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne kontratat e lidhura midis shoqerise "Albapower" Sh.p.k. dhe klienteve te saj. Te gjitha te drejtat dhe detyrimet midis paleve kontraktuale do ti kalojne shoqerise Perthithese "Xh.F.Kacos" Sh.p.k.
- Te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Debitoreve te shoqerise se perthithur Shoqeria "Albapower" Sh.p.k. do ti respektoje Shoqeria Perthithese "Xh.F.Kacos" Sh.p.k. ne vazhdimesi.
- Kreditoret, Furnitoret, Bankat, do te gezojne te gjitha te drejtat qe kane tek Shoqerite qe do te marrin pjese ne kete bashkim, pas ketij bashkimi te gjitha te drejtat e kreditoreve (Ortake, Furnitoret, Bankat) do te permbushen nga Shoqeria Perthithese "Xh.F.Kacos"Sh.p.k.
- Organet Tatimore, do te gezojne te gjithe te drejtat qe kane tek Shoqerite qe do te marrin pjese ne kete bashkim, pas ketij bashkimi te gjitha te drejtat e tyre do te permbushen nga Shoqeria Perthithese "Xh.F.Kacos"Sh.p.k.



- Punonjesit aktuale do te gezojne te gjithë te drejtat qe kane tek Shoqerite qe do te marrin pjese ne kete bashkim, pas ketij bashkimi te gjithë te drejtat e tyre do te permbushen nga shoqeria Perthithese "Xh.F.Kacos"Sh.p.k

- Shoqeria e perthithur " Albapower"Sh.p.k.,vleresohet e prishur, e cila do te ç'regjistrohet nga Qendra Kombetare e Biznesit.

12- Ligji i zbatueshem i Marreveshjes eshte ligji Shqiptar. Cdo mosmarreveshje apo konflikt ne lidhje me Marreveshjen do te zgjidhet perfundimisht nga Gjykatat kompetente Shqiptare.

Ky Projekt Marreveshje eshte nenshkruar ne kater kopjo origjinale ne gjuhe shqipe.

Per "Xh.F.Kacos"Sh.p.k.
ADMINISTRATORI
Z.Flavjo Kacos



Per "Albapower" Sh.p.k.
ADMINISTRATORJA
Zj.Esmeralda Lara

